



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Ferizaj / Osnovno Tužilaštvo Ferizaj / Ferizaj Basic Prosecution

AD.nr.1/25

Datë: 05.02.2025

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, duke vendosur lidhur me ankesën-kërkesë për inicim të procedurës disiplinore, të paraqitur nga [redacted] kundër Prokurores së Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj [redacted] në bazë të nenit 9 paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6, të Ligjit Nr. 06/L - 057, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, merr:

V E N D I M

HUDHET, ankesa-kërkesa për inicim të procedurës disiplinore, të paraqitur nga [redacted] kundër Prokurores së Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj [redacted], ngase me asnjë provë nuk është vërtetuar se e njëjta ka kryer ndonjë shkelje disiplinore, nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-057, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me datë 17.01.2025, ka pranuar shkresën-cedim i ankesës disiplinore me numër AD.nr.01/2025 nga U.D. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, [redacted], lidhur me ankesën-kërkesë për inicim të procedurës disiplinore kundër Prokurores së Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Ferizaj [redacted], të paraqitur nga [redacted].

Ankuesi [redacted] përmes ankesës së tij të paraqitur, pretendon se Prokurorja [redacted], ka kryer shkelje disiplinore në lëndën me numër [redacted] duke mos e trajtuar në mënyrë profesionale dhe ligjore, ku si rezultat i zhvillimit të hetimeve rezulton me ngritjen e aktakuzës ndaj tij për vepër penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Tutje në ankesën e tij, ka theksuar se aktakuza është ngritur kinse për një pjesë të një prone në fshatin [redacted] Komuna Hani i Elezit, duke e bazuar aktakuzën në pretendimet e personit [redacted] i cili kufizohet me pronën e prindit të ankuesit. I njëjti pretendon se kallëzimi penal i paraqitur ndaj tij është për shkak të urrejtjes që kanë [redacted] së bashku me djemtë e tij e të cilët kanë paraqitur edhe padi për kompensim dëmi dhe lirim prone pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, të cilën kopje të padisë e ka dorëzuar në Stacionin Policor Hani i Elezit.

Pas pranimit dhe analizimit të ankesës-kërkesës për inicim të procedurës disiplinore, të paraqitur nga ana e ankuesit, konsiderojmë se pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë për faktin se:

Bazuar në shkresat e lëndës [redacted] rezulton se Prokurori i Shtetit, ka ndërmarr veprime dhe ka vendosur për çështjen konform dispozitave ligjore, ashtu që me datën 10.05.2022, ka ngritur Aktakuzë pa zhvillimin e hetimeve ndaj të pandehurit [redacted] dhe [redacted] pasi që kishte ekzistuar dyshimi i bazuar mirë se në veprimet e të njëjtëve janë përmbushur elementet qenësore të veprës penale në bashkëkryerje Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, veprë kjo e cila nuk është e dënueshme me më shumë se tri vjet burgim.

Këtë dyshim të bazuar mirë prokurori i shtetit e ka mbështetur në provat materiale dhe personale edhe atë: raporti i oficerit me numër [redacted], i datës 28.01.2022, shënimi zyrtar me numër [redacted] i datës 28.01.2022, deklarata e të dëmtuarit [redacted] në Stacionin Policor Hani i Elezit, e datës 28.01.2022, Procesverbali për marrjen në pyetje të dëmtuarit-dëshmitarit [redacted] në Stacionin Policor Hani i Elezit, i datës 02.02.2022, Procesverbali për intervistimin e të pandehurit [redacted] në Stacionin Policor Hani i Elezit, i datës 03.02.2022, Procesverbali për intervistimin e të pandehurit [redacted] në Stacionin Policor Hani i Elezit, i datës 31.01.2022, Aktvendimi i Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me numër [redacted], i datës 24.06.2020, Aktvendimi për pushimin e hetimeve me numër [redacted], i datës 25.06.2020, Certifikata e pronësisë e lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për njësinë kadastrale [redacted], e datës 26.04.2022, Certifikata e pronësisë e lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për njësinë kadastrale [redacted], e datës 26.01.2022, Kopja e planit për Njësinë P- [redacted] e lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, e datës 26.01.2022, Legjenda e njësisë kadastrale [redacted] e datës 27.01.2022, e përpiluar nga [redacted] si dhe Foto dokumentacioni.

Në afatin ligjor të akuzuarit kanë paraqitur kërkesën për kundërshtim të provave dhe hudhje të aktakuzës.

Nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik është pranuar Aktvendimi i datës 19.04.2023, me të cilin aktvendim ishte aprovuar kërkesa për hedhje të aktakuzës si e bazuar, me ç'rast është hudhur Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, me arsyetimin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me çështje penale-juridike, por me çështje civilo-juridike e cila duhet zgjidhur në procedurë civile.

Kundër këtij aktvendimi, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit me aktvendim [redacted] të datës 21.12.2023, ka anuluar aktvendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje.

Gjykata Themelore në Ferizaj- Dega në Kaçanik, me rastin e rivendosjes ka vërejtur se nga i dëmtuari [redacted] është paraqitur padi për kompensim dëmi dhe ndalim të cenimit të së drejtës për shfrytëzim të paluajtshmerisë kundër [redacted] dhe të tjerëve. Po ashtu është

paraqitur edhe padi tjetër për lirim prone dhe kompensim dëmi, andaj gjykata ka konstatuar se meqë këto konteste gjyqësore të inicuar nga viti 2019 nuk janë ende të përfunduara sa i përket të njëjtës paluajtshmeri, pavarësisht faktit se i dëmtuari është pronar i pronës së paluajtshme fakt ky i kontestuar nga të akuzuarit dhe pasi që asnjëherë nuk është bërë ndarje fizike e kësaj njësie kadastrale, mirëpo pretendim i pa zgjidhur me vendim të formës së prerë nga Gjykata, andaj nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Nga të lartcekurat dhe pas vlerësimit të kërkesë për inicim të procedurës disiplinore së lartcekur, është konstatuar se në rastin konkret nuk ekziston asnjë shkelje disiplinore, e paraparë nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të ligjit Nr. 06/L - 057, për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pasi që Prokurori i Shtetit ka vendosur për çështjen konform dispozitave ligjore.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit.

Të njoftohet:

- Këshilli Prokurorial i Kosovës.
- Pala ankuese

